

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Ferizaj – Raporti komunal

Nëntor 2009

## Ferizaj në shifra

Popullsia	Gjithsej	143596
	Shqiptarë	97.1%
	Ashkali	2.6%
	Të tjerë	0.3%
Gjeografia	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	345
	Numri i fshatrave	44
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	11.81%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	35.07%
	E mesme	44.79%
	Shkollë e lartë	7.36%
	Universitet	0.97%
	Nr. i nxënësve	31,389
	Nr. i mësimdhënësve	1,425
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	6
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	38
	Nr. i çerdheve	1
	Shëndetësia	Spital
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare		1
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		15
Nr. i mjekëve		74
Papunësia	Gjithsej	41.90%
	Meshkuj	33.90%
	Femra	62.14%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	87,594
	Të punësuar në sektorin publik komunal	2,303
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	13,025,504
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	1,914,130
	Të hyrat tjera (Euro)	11,111,374
Shpenzimet e realizuara (2008) <sup>1</sup>	Gjithsej (Euro)	11,582,287 (90%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,839,672 (76%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	8,742,615 (96%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	35.61%
	LDD	22.76%
	LDK	14.74%
	AKR	14.47%
	AAK	4.07%
	PDAK	2.48%
	ORA	2.10%
	Tjera	1.99%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Adem Salihaj (LDK) 2002-2007: Adem Salihaj, LDK (2002-2004), Faik Grainca, LDK (2004-2007) 2007-2009: Bajrush Xhemajli (PDK)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Ferizajn

Vet qyteti i Ferizajt është vendbanim kryesisht i ri. Kjo komunë shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit dhe kap një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup>. Komuna e Ferizajt ka 44 fshatra ku në tërësi ka një popullatë prej 143,596 banorë. 97.1% e kësaj popullate janë shqiptarë, kurse 2.7% janë ashkali. Faktor me rëndësi ekonomike për Ferizajn ka qenë ndërtimi i vijës hekurudhore dhe stacionit hekurudhor. Historikisht ekonomia e Ferizajt ka zanafillën e saj në zejet dhe tregtinë e banorëve lokal. Por, Ferizaj ka pasur edhe shumë ndërmarrje publike të cilat tashmë kanë filluar të privatizohen, si kombinati i drurit, fabrika e vajit, fabrika e tullave etj. Ferizaji në Kosovë dallohet me bifurkacionin e lumit Nerodime, një fenomen unik në Evropë ku uji i një lumi derdhet në dy dete. Ferizaj ka edhe shumë objekte tjera me karakter kulturor dhe historikë si Kisha Dardane, Ujësjiellësi i kohës iliro-romake, varrezat ilire etj.

## Problemet aktuale

Hekurudha që kalon përmes Ferizajt në njërën anë i ka sjellë përfitime ekonomike këtij qyteti por në anën tjetër vazhdimisht ka paraqitur rrezik për sigurinë e qytetarëve. Jo rrallë aksidente të tilla kanë qenë edhe fatale. Siguria e përgjithshme në qytet gjithashtu është problem serioz. Ndër problemet që kërkojnë zgjidhje më urgjente në këtë komunë janë:

- Hekurudha
- Mungesa e hapësirave gjelbëruese
- Mbeturinat
- Siguria
- Rrëmuja në komunikacion

Kalimi i **hekurudhës** përmes qytetit të Ferizajt ka qenë një problem i kamotshëm për qytetarët. Treni i cili kalon nëpër qytet shpesh vë në rrezik jetën e banorëve të këtij qyteti. Tashmë është bërë shprehi e qytetarëve që të kalojnë hekurudhën për të dalë në anën tjetër të qytetit, duke vënë në rrezik jetën e tyre pasi që aty mungon një vendkalim për të kaluar matanë hekurudhës. Për ta parandaluar këtë rrezik komuna ka vendosur të ndërtoj një mur përgjatë hekurudhës në mënyrë që t'u pamundësohet qytetarëve kalimi nëpër hekurudhë. Në këtë projekt parashihet edhe ndërtimi i disa urave kaluese. Por, deri në finalizimin e këtij projekti, qytetarët vazhdojnë traditën e vjetër të kalimit nëpër hekurudhë, gjë që mbetet shqetësuese për të gjithë Ferizajasit. Si masë tjetër mbrojtëse ka filluar edhe ndërtimin e një muri rreth autostradës. Megjithatë, edhe ndërtimi i murit mbrojtës ka krijuar një problem të ri. Muri i cili është duke u ndërtuar e ka ndarë qytetin në dysh dhe i ka dhënë një pamje të vrazhdë qytetit. Ky mur ka filluar të quhet me ironi si "Muri i Berlinit". Vlen të përmendet që në konferencën e donatorëve, Ferizaj ka konkuruar për projekte në vlerë rreth 260 milion euro, ku parashihej edhe ndërtimi i një hekurudhe nëntokësore dhe treni nëntokësor

**Mungesa e hapësirës së gjelbër** (parqeve) është një problem tjetër që shqetëson qytetarët e Ferizajt. Përderisa komuna është orientuar në drejtim të asfaltimit të rrugëve dhe kubëzimit të trotuareve, qytetarët kanë nevojë më shumë për hapësirat gjelbëruese. Në një qytet ku ka komunikacion të dendur dhe ndotje të shumtë të

ajrit, qytetarët konsiderojnë se ka më tepër nevojë për gjelbërim dhe parqe për pushim. Edhe pse ekzistojnë disa, ato vizitohen mjaft pak nga pushuesit pasi që ato në përgjithësi janë në gjendje të papastër dhe jo të mirëmbajtura. Ndërsa, parku i ri i qytetit i cili është ndërtuar në pjesën e rrënojave për skaj hekurudhës, nuk është ndërtuar si park me hapësira gjelbëruese por si një shesh, pasi që ka më shumë beton se gjelbërim. Komuna ka mbjellë një numër të konsiderueshëm të fidaneve dhe drunjve në pjesën lindore të hekurudhës, mirëpo qytetarët nuk mjaftohen vetëm me këtë pasi që ata kërkojnë një apo më shumë parqe ku mund të dalin dhe të pushojnë.

**Mbeturinat.** Mungesa e një deponie të qytetit për grumbullimin e mbeturinave është një tjetër problem me të cilin po ballafaqohen qytetarët e Ferizajt. Deponimi i mbeturinave deri më tani është bërë në Gjilan, ku autoritetet e atjeshme në mënyrë indirekte kanë penguar kompaninë “Pastërtia” të hedh mbeturinat në atë deponi. Duke u ballafaquar me këtë problem mjaft të madh, qytetarët konsiderojnë se qyteti duhet të ketë deponinë e vet, e cila doemos do të përmirësonte nivelin e pastërtisë në qytet.

**Siguria e banorëve të Ferizajt** është një problem tjetër. Për nga numri i popullsisë, Ferizaj me 143,596 banorë radhitet si komuna e tretë, menjëherë pas Prishtinës dhe Prizrenit. Por sa i përket rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit, Ferizaj radhitet e dyta në Kosovë me 9,982 raste gjatë vitit 2008, menjëherë pas Prishtinës e cila gjatë 2008 ka shënuar 10,830 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit. Por, kur e shikon dallimin me numrin e popullsisë në mes Prishtinës dhe Ferizajt, del se për kokë banori në Ferizaj kanë ndodhur më së shumti raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në krahasim me komunat tjera. Gjatë vitit 2008, në territorin e kësaj komune kanë ndodhur 539 raste të shkakimit të dëmeve trupore (587 në Prishtinë), 411 raste të kërcënimeve (473 raste në Prishtinë), 152 raste të mashtrimeve (163 në Prishtinë), 39 vrasje (43 në Prishtinë), etj. Mbetet shqetësuese edhe dhuna nëpër shkolla. Për rastet e dhunës nëpër shkolla Drejtoria e Arsimit nuk ka statistika të sakta, kurse në statistikat e policisë këto raste nuk ndahen nga rastet e tjera dhe është vështirë të dihet se sa prej rasteve me dëmtime trupore apo kërcënime kanë ndodhur në hapësirat shkollore. Por për nxënësit dhe prindërit dhuna në shkolla mbetet një problem i madh. Në këtë komunë që nga 2008 kanë ndodhur shumë raste të sulmimit të bizneseve nga persona të panjohur, siç është rasti me sulmet e disa hershme në supermarketin “Viva”.

Edhe Ferizaj ka probleme me **rregullimin e komunikacionit rrugor**. Ferizaj nuk ka pasur plan urbanistik të qytetit deri në fund të vitit të kaluar, plan i cili ka kaluar në Kuvendin Komunal përkundër shumë defekteve që ka pasur dhe askush nuk beson se ky plan do të jetë i zbatueshëm pasi nuk përkon me nevojat e qytetit dhe realitetin në terren. Si pasojë e mungesës së planeve, rrugët e qytetit janë ngushtuar së tepërmi duke bërë që automjetet në shumë nyje rrugore të kenë vështirësi për të kaluar lirshëm. Problemi më i madh vërehet tek udhëkryqi afër hekurudhës dhe stacionit të autobusëve. Në këtë udhëkryq tollovia shkaktohet nga automjetet që vinë nga drejtimi i Gjilanit, automjetet që vinë nga drejtimi i Vitisë, Prishtinës dhe daljet që bëhen nga qyteti i Ferizajt. Këtë e rëndon edhe më shumë stacioni i autobusëve nga i cili hyjnë dhe dalin vazhdimisht autobusët duke shkakuar ndërprerjen e komunikacionit të automjeteve tjera. Ky udhëkryq nuk ka semafor të rregulluar si dhe policia rrallë është prezent në këtë pikë. Këtë gjendje e kanë rënduar edhe më shumë punimet që janë duke u kryer në rrugë në brendi të qytetit, të cilat janë zvarritur dhe kjo ka shkakuar probleme në komunikacion. Mungesa e parkingjeve

është problem tjetër që mund të hyjë në këtë mes, pasi automjetet në mungesë të parkingjeve publike, parkojnë ato në trotuare dhe skaj rrugëve.

**“Bifurkacioni”**. Kosova njihet për një fenomen të rrallë natyror, që ka qëlluar të jetë në Ferizaj: bifurkacioni i lumit Nerodime. Bifurkacioni i lumenjve është fenomen i rrallë natyror dhe përveç se në Ferizaj ekziston edhe në Amerikën Latine. Më saktësisht, në Ferizaj ky fenomen tani është shuar, pasi që lumi Nerodime nuk ndahet në dy lumenj, por në mungesë të prurjes së ujit ai ndahet vetëm në një lum. Në mos funksionimi i fenomenit të bifurkacionit ka ndikuar edhe moti i nxehtë dhe prurjet gjithnjë e më të pakta ujit. Por në zhdukjen e këtij fenomeni ka ndikuar edhe faktori njeri, qoftë duke derdhur ujërat e zeza në lumin Nerodime, mos pastrimi i shtratit të lumenjve, etj. Zona për rreth bifurkacionit në Ferizaj, në një hapësirë prej 13ha ka qenë vënë nën mbrojtje shtetërore (zonë me interes të veçantë) qysh në vitin 1979. Komuna dhe Ministria e Ambientit i hedhin fajin njëra tjetrës në drejtim të asaj se kush duhet përkujdesur për këtë zonë. Në konferencën e donatorëve në vitin e kaluar, Ferizaj ndër të tjera ka kërkuar mjete për tu përkujdesur për këtë fenomen. Zhdukja e këtij fenomeni nuk paraqet ndonjë preokupim të madh tek qytetarët, për shkak të problemeve më të mëdha të përditshme, mirëpo kjo duhet të trajtohet nga organet komunale dhe të nivelit qendror pasi që është një referencë shumë e mirë turistike dhe mund t'i sjell përfitime të shumëfishta Ferizajt. Në stemën zyrtare të komunës së Ferizajt, përveç hekurudhës, Mic Sokolit, ndodhet edhe degëzimi i lumit Nerodime; çfarë tregon se komuna e vlerëson këtë fenomen si vlerë, mirëpo duhet të përkujdeset edhe për ta mbrojtur.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Zgjedhjet e 17 Nëntorit 2007 dërguan në balotazh kandidatin e PDK Bajrush Xhemajli dhe kandidatin e LDD Sahit Krasniqi, ish shef i ekzekutivit të komunës. Në këto zgjedhje Bajrush Xhemajli fitoi 14,562 vota apo 40.34% %, kurse përfundimisht Xhemajli e siguroi postin e të parit të komunës në zgjedhjet e balotazhit ku fitoi 14,466 vota apo 62.08%.

Në fushatën para zgjedhore të vitit 2007 qytetarëve të Komunës së Ferizajt PDK u kishte dhënë një sërë premtimesh. Dy vite më vonë qytetarët vlerësojnë se shumica e premtimeve janë realizuar. Prej premtimeve më madhore kishte qenë përmirësimi i situatës me ujin e pijshëm. Ky projekt është realizuar falë një donacioni nga qeveria zvicerane, ku është përmirësuar dukshëm gjendja e ujësjellësit jo vetëm në qytet por edhe në disa fshatra. Premtimet janë mbajtur edhe sa i përket infrastrukturës së rrugëve. Rruga për Jezercë është asfaltuar gjatë vitit 2008, kurse në fshatin Mirashë është asfaltuar rruga në brendi të fshatit. Ferizaj ka pasur problem të madh edhe me kanalizimin. Edhe ky premtim është qar në vend nga pushteti komunal. Kanalizimet janë ndërtuar në disa fshatra si Balaj, Prelez, Greme. Megjithatë edhe këtu ka pas ca lëshime ngase nuk është ndërtuar kolektori që do të përshkonte brigjet e lumit Nerodime deri në Gurez ashtu siç është premtuar. Premtim shumë me rëndësi kishte qenë edhe ndërtimi i mbikalimeve të hekurudhës, në mënyrë që të evitohen aksidentet e mundshme nga kalimi i trenit. Ky projekt është realizuar pjesërisht, ngase dy vite më vonë është ndërtuar vetëm muri përgjatë hekurudhës por jo edhe mbikalimet siç ishte paraparë, të paktën jo deri më tani. Një mospërmbyshje e premtimeve është vërejtur edhe në projektin e paraparë për asfaltimin e rrugës Greme-Grackë-Bajc. Kjo rrugë ende nuk është asfaltuar.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Investimi në ujësjellës, ngase 40% e komunës së Ferizajt nuk ka ujësjellës.	Përmirësimi më ujë të pijshëm është bërë falë një donacioni afër 4 milionësh nga qeveria Zvicerane, falë të cilit investim kapacitetet e ujit do të rriten në 210 litra për sekondë. Komuna ka ndikuar që pengesa e bërë nga një hurdhë e peshqve në fshatin Jezerc të rrënohet ngase ndikonte në ndotjen e ujit. Janë bërë intervenime në rrjetin e ujësjellësit në vlerë prej 250.000 eurove, në pjesën lindore të Ferizajt, në Komogllavë, Greme, në fshatin Gaçkë, Zllatar.
Asfaltimi i rrugës Greme-Gaçkë-Baiç.	Kjo rrugë ende nuk është asfaltuar.
Asfaltimi i rrugës për Jezerc	Kjo rrugë është asfaltuar gjatë 2008.
Asfaltimi i rrugës për Mirashë	Është asfaltuar vetëm një rrugë në brendi të fshatit, në lagjen e Xhamisë.
Investime në rrjetin e kanalizimit	Është investuar në ndërtimin e kanalizimit në fshatin Balaj, , në fshatin Prelez i Muhaxhirëve, kanalizimi në rrugën “Epopeja e Jezercit”, kanalizimi në fshatin Greme (30km gjatësi), kanalizimi në rrugën “Driton Islami”. Mirëpo, nuk është ndërtuar kolektori që do të përshkonte brigjet e lumit Nerodime e deri në Gurëz, ashtu siç është premtuar.
Investimet në ndërtimin e mbikalimeve dhe nënkjalimeve në hekurudhë	Është bërë edhe zhvendosja e stacionit të trenit për ngarkim dhe shkarkim të mallrave, kjo zhvendosje është bërë nga qyteti në fshatin Greme. Është duke u ndërtuar muri për rreth hekurudhës, por nuk ka nënkjalime dhe mbi kalime, ashtu siç është premtuar.

## Zgjedhjet lokale në Ferizaj

Nga tri mandatet qeverisëse deri më tani, me komunën e Ferizajt dy herë ka qeverisur LDK dhe një herë PDK. Në zgjedhjet e para të vitit 2000, vetëm tri parti kishin arritur të sigurojnë ulëse në KK; LDK, PDK dhe AAK. LDK kishte dalë fituese në këto zgjedhjet me 28,141 vota, PDK e dyta me 11,077 vota kurse AAK e treta me 821 vota. Nga 41 ulëse në KK, LDK kishte marrë shumicën, 29 ulëse, PDK 11 ulëse dhe AAK vetëm 1. Zgjedhjet e vitit 2002 i kishte fituar përsëri LDK, por kësaj here kishte humbur disa ulëse në KK. Me 25,746 vota LDK kishte siguruar 24 ulëse apo pesë më pak se në mandatin paraprak. PDK kishte siguruar 12 ulëse në saje të 12,648 votave të fituara, përderisa AAK kishte marrë 2 ulëse dhe 3 ulëset e mbetura ishin ndarë mes PDAK,PSHDK dhe DCC. Zgjedhjet e vitit 2007 kishin sjellë një përfundim pak më ndryshe. Në këto zgjedhje për herë të parë qeverisja lokale kishte kaluar nga LDK te PDK. Me 12,050 vota të fituara PDK kishte arritur të sigurojë numrin më të madh të ulëseve në KK, gjithsej 15. Parti e dytë me numër të ulëseve doli të jetë LDD me 9 ulëse, kurse AKR dhe LDK kishin siguruar nga 6 ulëse. Tabela e më poshtme

ofron detaje të rrjedhjes së zgjedhjeve në komunën e Ferizajt. Kryetar komune që nga vitit 2007 është Bajrush Xhemajli, i cili është rikandiduar përsëri në zgjedhjet e Nëntorit 2009.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Ferizajt.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	11077	11	12648	12	12050	15
LDK	28141	29	25746	24	4989	6
AAK	821	1	1658	2	1379	2
LDD	-	-	-	-	7704	9
AKR	-	-	-	-	4897	6
PDAK	-	-	899	1	838	1
ORA	-	-	-	-	710	1
PD	-	-	-	-	637	1
PSHDK	-	-	673	1	-	-
DCC	-	-	1013	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte tejte e kënaqshme me 75.5%, në zgjedhjet e vitit 2002 ra në 57.8%. Ndërkaq, në zgjedhjet e vitit 2007 numri i votuesve ra edhe më shumë në 33,843. Në përgjithësi në komunat e Kosovës përderisa numri i qytetarëve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, numri i pjesëmarrësve në votime ka shkuar duke rënë. Kjo lë dyshimin se edhe në zgjedhjet e nëntorit 2009 numri i votuesve do të jetë edhe më i vogël. Të drejtë vote në këtë komunë kanë 88,305 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Ferizaj në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	57724	76350	?	88305
Pjesëmarrja në votime	43581	44146	33843	-
Përqindja e daljes në votime	75.5%	57.82%	?%	-

## Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2009 është 13,025,503 euro. Ky njëherit është edhe buxheti më i madh që ka pasur kjo komunë ndonjëherë. Po të krahasohet me vitin 2008, këtë vit komuna ka pasur buxhet më të madh për 2,683,313 euro. Sikurse buxheti i përgjithshëm edhe shpenzimet për vitin 2009 kanë qenë më të larta. Vetëm për shpenzime kapitale këtë vit janë ndarë afër 4 milion euro, kurse për rroga dhe mëditje kanë shkuar afër 7 milion euro. Po të shikohet buxheti i komunës nëpër vite mund të vërejmë se në vitet 2004-2005 Ferizaj ka pasur një buxhet prej rreth 10 milion euro. Por, vitet në vitet 2006-2007 planifikimi buxhetor kishte rënë në 9 milion, për tu



rritur përsëri në 10 milion në vitin 2008. Përndryshe, planifikimet buxhetore të vitit 2009 janë dyfishuar që nga viti 2003.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€6,985,410	€1,323,505	€417,306	€382,703	€3,916,579	€13,025,503
2008	€5,832,227	€1,402,959	€433,020	€292,000	€2,381,984	€10,342,190
2007	€5,586,756	€1,417,027	€407,243	€307,000	€1,877,426	€9,595,452
2006	€5,546,685	€1,140,161	€320,422	€185,000	€2,255,572	€9,447,840
2005	€5,211,378	€1,230,899	€297,200	€159,000	€3,162,475	€10,060,952
2004	€5,340,689	€1,673,111	-	-	€2,974,764	€10,417,102
2003	€4,046,520	€1,428,808	-	-	€2,161,370	€7,867,863

Përveç ngritjes së buxhetit total, nga tabela e mësipërme mund të shohim se ka pasur kryesisht edhe lëvizje në buxhetin e ndarë për rroga dhe mëditje. Në të vërtetë, nga buxheti i vitit 2009, pjesa më e madhe është ndarë për rroga dhe mëditje që ishte 6,985,410 euro.

## Investimet kapitale

Vetëm gjatë vitit 2009 për investime kapitale janë ndarë 3,916,579 euro nga buxheti total. Ndërkaq edhe në vitin 2008 janë ndarë mbi 2 milion euro për po të njëjtin qëllim. Nga këto mjete janë investuar këto projekte kapitale:

Tab.5.: Investimet kapitale në Ferizaj gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Talinoc	€74,300
2008	Rregullimi i infrastrukturës - rruga e Reçakut	€130,000
2008	Asfaltimi i rrugës "Kadri Zeka"	€212,788
2008	Ndërtimi i shkollës në fshatin Dërmjak	€100,000
2008	Asfaltimi i rrugës së Reçakut	€153,216
2008	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Epopeja e Jezercit	€81,050
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Greme	€100,000
2009	Rregullimi i rrugës në lagjen N. Beka dhe E. Topa	€125,146
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Balaj	€127,500
2009	Ndërtimi i QMF-së	€150,000
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Greme (faza e II-të)	€200,000

Kuvendi Komunal i Ferizajt ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Ferizajt do të ketë në dispozicion 17,441,209 euro për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim



të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Ferizajt për mandatin e tij qeverisë katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth 23.7 milion euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Ferizaj 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	15,384,963	15,828,373	16,373,851
Të hyrat vetanake në €	2,731,468	2,818,181	2,899,474
Investimet kapitale në €	5,479,986	5,780,485	6,180,738

## Administrata komunale

Numri total i të punësuarve në arsim, shëndetësi, dhe administratë në komunën e Ferizajt është 2,303 punonjës. Numri i punonjësve krahasuar me vitin 2008 është rritur për 17 persona. Në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46, komunat me mbi 100,000 banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 750 banorë. Sipas kësaj, Ferizaj duhet të ketë 203 punonjës në administratën komunale, ndërkohë që për momentin ka 231 të punësuar, që do të thotë se duhet reduktuar stafin e administratës komunale.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Ferizajt sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	2303 ▲
2008	2286 ▲
2007	2270
2006	2277 ▲
2005	2263
2004	2267 ▲
2003	2040 ■

## Komuna e Ferizajt dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, kuvendi komunal duhet të mbajë të paktën 10 mbledhje. Kuvendi Komunal i Ferizajt ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, duke tejkalluar kështu normën e paraparë. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, kuvendi komunal i kësaj komune ka mbajtur 5 mbledhje, duke përmbushur kështu normën e paraparë me nenin 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Edhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 10 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Sa i përket transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarët, komuna e Ferizajt ka mbajtur 3 debate me qytetarë gjatë vitit 2008, kurse në gjashtë mujorin e parë të vitit 2009 nuk është mbajtur asnjë debat. Gjatë vitit 2008 komuna ka pranuar dy kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare, përderisa asnjë peticion nuk është dorëzuar nga ana e qytetarëve gjatë vitit 2008.

Komuna e Ferizajt edhe uebfaqen e saj zyrtare. Por kjo uebfaqe ka shumë mungesa në informacione. Tabela 8 pasqyron një vlerësim për secilën kategori të uebfaqes.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Dragashit (<http://www.ferizaj-komuna.org>)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
Ballina	3
Organizimi komunal	3
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	1.88
Projektet komunale	1.5
Lajme & lajmërimet	4.67
Harta e faqes	1
Kontakt	3
Gjuhët	1
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	2.5
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	19

## Gjendja në arsim

Komuna e Ferizajt sistemin arsimor e ka të organizuar në tri nivele, atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Për nevoja e parashkollorëve ekziston vetëm një çerdhe në këtë komunë, kurse numri i parashkollorëve arrin në 2,189. Këta fëmijë përveç çerdhes shfrytëzojnë edhe klasat e shkollave fillore. Në komunën e Ferizajt ekzistojnë 31 shkolla fillore, apo 38 bashkë me paralelet e ndara, dhe 6 shkolla të mesme. Në total numri i nxënësve në këtë komunë është 31,389, kurse numri i mësimdhënësve në komunën e Ferizajt arrin në 1,425. Sa i përket raportit 1 punonjës për 100 banorë, kjo komunë ka 1.2 punonjës për 100 banorë. Përderisa Ferizaj hyn në mesin e komunave të mëdha të Kosovës, ekziston nevoja për hapësira më të mëdha të objekteve shkollore. Momentalisht në këtë komunë çdo nxënës ka hapësirë prej 0.95 m<sup>2</sup>, që konsiderohet si progres krahasuar me hapësirën e dikurshme prej 0.60 m<sup>2</sup>. Në Ferizaj ekziston edhe fakulteti i Shkencave Aplikative dhe Fakulteti i Mësuesisë.

<sup>2</sup> Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

## Gjendja në shëndetësi

Në qytetin e Ferizajt ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare si dhe dy Qendra të Mjekësisë Familjare, që do të thotë qyteti ka gjithsej 3 qendra të mjekësisë familjare si dhe spitalin e qytetit. Ndërkohë veç është vënë gurëthemeli për ndërtimin e Qendrës së katër të mjekësisë familjare, afati i përfundimit të së cilës nuk dihet ende. Megjithatë qyteti nuk ka një Qendër Emergjente, edhe pse me ligj parashihet që në një vend me mbi 150,000 banor të ketë Emergjencën e vet. Pra, përveç spitalit, komuna e Ferizajt ka QKMF, dhe 15 QMF dhe punkte shëndetësore. Kurse QKMF ka gjithsej 74 mjek në shërbim të qytetarëve. Në punktet shëndetësore nëpër fshatra punohet çdo dite nga 8 orë. Kjo komunë ka gjithsej 6 vetura të ndihmës së shpejtë, të cilat janë dhuratë e donatorëve të ndryshëm. Në përgjithësi Komuna e Ferizajt ka 2.2 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë që nuk është numër i mjaftueshëm krahasuar me komunat tjera të Kosovës.

## Shoqëria civile

Ferizaj ka shoqërinë civile më të organizuar në krahasim me komunat tjera. Në komunën e Ferizajt, veprojnë disa organizata jo-qeveritare ku më me ndikim mund të cekem: INPO, FIQ, AVONET, "Ardhmëria e qytetit të Ferizajt", si dhe organizata jo-qeveritare që si mision të saj ka mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe ndërmarrjen e iniciativave që kanë të bëjnë me risocializimin e femrave që iu kanë nënshtruar trafikimeve apo dhunës. Këto organizate njihen nga qytetarët e komunës si mjaft aktive ku pjesën më të madhe të misionit të tyre e përqendrojnë në avokimin si dhe mbikëqyrjen e gjitha vendimeve, iniciativave, si dhe marrin pjesë në debate të karaktereve të ndryshme.

## Mediat lokale

Mediat po ashtu luajnë një rol të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të informimit të qytetarëve rreth zhvillimeve që ndodhin në komunë. Mediumet lokale që konsiderohen si më me ndikim dhe më të angazhuara në përmbushjen e misionit të informimit të qytetarëve, janë TV Tema, TV Liria, si dhe korrespondentët e së përditshmeve Express dhe Koha Ditore. Debatet në mes të zyrtarëve komunal dhe shoqërisë civile që janë me interes për banoret e Ferizajt, transmetohen në televizionet lokale të cilat u përmenden më lartë.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Ferizajt

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Ferizajt kanë ndodhur 9,982 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 90 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Ferizaj (2008)

Natyrë e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	2821
Prishja e rendit dhe	272

qetësisë publike	
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	73
Vjedhje e pyjeve	3
Incidente lidhur me pronën	203
Vjedhje	3422
Abuzime seksuale	37
Shkaktim të dëmtimeve trupore	539
Kërcënime	411
Mashtrime	152
Vrasje	39
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

Rendi dhe qetësia në Komunën e Ferizajt nuk është në gjendje të lakmueshme. Ferizaj zë vendin e dytë në Kosovë për nga numri i madh i aksidenteve në trafik. Vetëm gjatë vitit 2008 janë shënuar 2,821 aksidente. Ferizaj renditet i treti për nga numri i madh i prishjes së rendit dhe qetësisë publike, me 272 raste gjatë një viti. Gjatë vitit 2008 është shënuar numër i madh i vjedhjeve gjithashtu, gjithsej 3,422 raste duke e rëndit këtë komunë në vendin e dytë menjëherë pas Prishtinës. Në vendin e dytë Ferizaj renditet edhe për nga numri i madh i abuzimeve seksuale (37), kërcënimeve (411), shkaktim të dëmtimeve trupore (539) dhe ajo që është edhe më shqetësuese vrasjeve (39).

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimoret mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimoret lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Ferizajt

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	<b>Norma tatimore</b>				
	0.09%	0.09%	0.22%	0.18%	0.09%
I	450€	400€	950€	460€	100€
II	420€	350€	870€	430€	90€
III	400€	300€	800€	400€	80€
IV	325€	250€	500€	350€	60€

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në Komunën e Ferizajt janë të regjistruara rreth 3,430 biznese. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	2,000 €
Kompanitë e sigurimit	750 €
KEK	2,000 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	2,000 €
Agjensionet turistike	150 €
Hotelet	500 €
Motelet	500 €
Supermarketet-Hipermarketet	500 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	
Kafeteritë	250 €
Restorant	500 €
Radiotelevizionet	250 €
Veprimtarite higjienike (uji, mbeturinat)	200 €
Barnatoret (Farmacitë)	100 €
Autoshkollat	
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 €
Ndërmarrjet (ndërtimore, industriale, etj.)	100 €
Pompat e benzinës	1,000 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	200 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.